



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC

Numri i lëndës: 2023:287533

Datë: 31.01.2024

Numri i dokumentit: 05263309

PPP. nr. 86/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË GLLOGOC Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Astrit Gashi, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorëve S.A, T.H, Y.D, H.T, F.M dhe N.Z të gjithë punëtorë në SHMU “H...” në Glllogoc, të cilët i përfaqëson D.K, kundër debitorit Komuna e Glllogocit-Drejtoria e Arsimit, lidhur me borxhin në emër të Kamatës ligjore, gjithsejt në shumën prej 571.71 €, duke vendosur në prapësimin e ushtruar nga debitori, kundër urdhërit për lejimin e përmbarimit të Përmbaruesit F.C, P.nr... të datës 17.11.2023, jashtë seancës me datë 22.01.2024 e mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET prapësimi i debitorit Komuna e Glllogocit-Drejtoria e Arsimit kundër urdhërit të Përmbaruesit Privat P. nr... të datës 17.11.2023, me të cilin është lejuar propozimi i kreditorëve S.A, T.H, Y.D, H.T, F.M dhe N.Z të gjithë Punëtorë në SHMU “H...” në Glllogoc - për përmbarimin e borxhit në shumën prej 571.71 €, ndërsa urdhëri i Përmbaruesit Privat P.nr... të datës 17.11.2023 **mbetet në fuqi**.

A r s y e t i m

E autorizuar e Kreditorëve S.A, T.H, Y.D, H.T, F.M dhe N.Z të gjithë Punëtorë në SHMU “H...” ne Glllogoc ka parashtruar propozim të Përmbaruesi Privat për lejimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të përmbarueshëm të Aktgjykimit C. nr. 446/19 i datës 11.02.2021 lidhur me pagesën e borxhit ne emër te kamatës ligjore siç është cekur në dispozitiv te aktgjykimit C. nr. 446/19 i datës 11.02.2021 në lartësi prej 571.71 €, si dhe shpenzimet e procedurës, të gjitha këto në afat 7 ditor në të kundërtën, të bllokohen llogaritë bankare të debitorit, e nëse nuk ka mjete në llogari të bëhet regjistrimi, sekuestrimi, vlerësimi dhe shitja e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme e mjetet e mbledhura të derdhen në llogari të kreditorit.

Përmbaruesi Privat F.C duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit, ka lëshuar urdhër P. nr... me datë 05.12.2023 me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të aktgjykimit C. nr. 446/19 e datës 11.02.2021.

Debitori ka paraqitur prapësim kundër urdhërit për lejimin e përmbarimit në afatin ligjor me arsyetimin se fillimisht pala kreditore shumë e kërkuar ka mundur ta realizoj përmes propozimit për përmbarim të dorëzuar pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë Dega në Glllogoc e cila e mbanë shenjen CP. nr.676/2022 në të cilin propozim përveç borxhit kryesor pala kreditore ka kërkuar edhe kamatën ligjore prej 8% në vit. Po ashtu theksojnë se nuk janë të obliguar të paguajnë kamatën pasi që është një lëshim i kreditores me rastin e paraqitjes së propozimit për përmbarim të mëparshëm, andaj ka kërkuar që në vështrim të Nenit 73 par. 3 të LPP-së të aprovohet si i bazuar prapësimi i tij dhe të refuzohet si i pa bazuar urdhëri për përmbarim i përmbaruesit privat.

Kreditore në afatin ligjor ka paraqitur përgjigje në prapësim duke kundërshtuar prapësimin e debitorit në tërësi si të pa bazuar dhe të pa argumentuar me asnjë provë, andaj i ka propozuar gjykatës që të refuzoj prapësimin e debitorit dhe urdhëri P. nr... i datës 17.11.2023 të mbetet në fuqi.

Gjykata ka shqyrtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se prapësimi i debitorit është pa i bazuar, ndërsa kundërshtimet e prapësimin të dhëna nga kreditore në përgjigje në prapësim, gjykata i konsideroi si të qëndrueshme dhe atë për këto arsye.

Me shikimin e shkresave të lëndës vërtetoi faktin se kreditore, propozimin për përmbarim e ka bërë për përmbarimin e dokumentit të përmbarueshëm-Aktgjykimit C.nr.446/19 i datës 11.02.2023 të lartëcekur për shkak të detyrimit në të holla si më lartë-kamatë ligjore, i cili propozim është lejuar me urdhërin e Përmbaruesit Privat e me propozimin e mjeteve gjegjëse të përmbarimit të parapara me dispozitat ligjore të LPP-së për realizimin e detyrimit në të holla që rrjedh nga këto Aktgjykimi si në rastin konkret.

Lidhur me atë se me çfarë baze juridike caktohet përmbarimi, se çka përmbar dokumenti i përmbarimit, se çka duhet të përmbarjë një propozim për përmbarim të dokumentit të besueshëm, si dhe kushtet ligjore për caktimin e përmbarimit në bazë të ekstrakteve janë të përcaktuara me dispozitat ligjore të Nenit 21, 22, 29, 30, 37, 38 dhe 40 të LPP-së, ndërsa shkaqet e prapësimin janë përcaktuar në Nenin 71 të LPP-së, e në rastin konkret kemi të bëjmë me dokument të përmbarueshëm-titull përmbarimor nga i cili shihet se debitori ia ka borxhin në fjalë kreditorit.

Debitori në prapësimin e tij ka pretenduar se nuk ka obligim ndaj Kreditores lidhur me kamatën ligjore sepse për të njejtën përmbaruesi privat është dashur të veprojnë sipas detyrës zyrtare përmes nxjerrjes së ekspertizës dhe llogaritjes së shumës për kamatën prej 8% në lëndën CP.nr. 676/2022, Gjykata nuk e aprovoj këtë pretendim e debitorit pasi që nuk bazë ligjore lidhur me pretendimet të paraqitura në prapësim sepse kreditore në atë procedurë ka realizuar vetëm borxhin kryesor dhe tani ka paraqit propozim për përmbarim të shumës së kamatës ligjore, ndërsa kreditore në anën tjetër propozimit për përmbarim i ka bashkangjitur Aktgjykimin C. nr. 446/19 të datës 11.02.2021 në kopje origjinale të noterizuar, i cili i plotëson kushtet ligjore për të u trajtuar dokument i përmbarueshëm në kuptim të Nenit 22 par. 1.1 të LPP-së.

Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke e refuzuar prapësimin e debitorit dhe ka lënë në fuqi urdhërin përmbarues për caktimin e përmbarimit P.nr... të datës 20.10.2023, duke u bazuar në Nenin 73 par. 3 të LPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Dega në Glllogoc

Departamenti i Përgjithshëm, PPP. nr. 86/23, datë 29.01.2024,

Gj y q t a r i
Astrit Gashi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej shtatë (7) ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.